

VENDIM
Nr. 427, datë 15.5.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS
QENDËR KRYEVIDH, SHKOLLA 9-VJEÇARE NË KOMUNËN E KRYEVIDHIT TË QARKUT TË
TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës Qendër Kryevidh, shkolla 9-vjeçare, në komunën e Kryevidhit të qarkut të Tiranës.
 2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) m² objekt, pronë private që shpronësohet, si dhe pronarët që shpronësohen janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 800 000 (tetëqind mijë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i komunës së Kryevidhit.
 4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Kryevidhit.
 6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Kryevidhit për realizimin e këtij projekti.
 7. Shpronësimi bëhet në favor të komunës së Kryevidhit. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) m² objekt, shpronësuar në favor të kësaj komune, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kryevidh për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS QENDËR KRYEVIDH, SHKOLLA 9-
VJEÇARE NË KOMUNËN E KRYEVIDHIT, QARKU TIRANË**

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. objekt m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadast.	Dok. i pronësisë
1	Bahri Pjeçi	66	12 121	800 000	142/24	2292	Në proces
	TOTALI	66		800 000			